

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv takim me përfaqësues të medias

Vështrim mbi tregjet

- Ecuria e tregut të sigurimeve në Shqipëri, Janar–Nëntor 2022

Zhvillime të tjera

- Përafrimi legjislativ me BE-në dhe praktikat mbikëqyrëse, AMF dhe MFSA nënshkruajnë Memorandum Mirëkuptimi
- Tryeza diskutimi me përfaqësues të tregut mbi kuadrin rregullator të tregjeve të kapitalit

Publikime Profesionale

- IAIS Publikohet “Raporti i Tregut Global të Sigurimeve 2022”

Informacione Ndërkombëtare

| | | | |
|--------|----------|----------|-------|
| Greqi | Hungari | Poloni | Qipro |
| Rumani | Sllovaki | Slloveni | Turqi |

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin



Tiranë, 28 dhjetor 2022 – AMF takim me median

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Z. Ervin Mete, zhvilloi një takim me gazetarë të shtypit të shkruar dhe mediave elektronike, të profilizuar në pasqyrimin dhe raportimin e lajmeve mbi ekonominë dhe tregjet financiare në Shqipëri.

Takimi u hap nga fjala përshëndetëse e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv, i cili falenderoi përfaqësuesit e medias për profesionalizmin dhe korrektësinë e treguar në pasqyrimin e lajmeve dhe ngjarjeve kryesore ekonomike e financiare përgjatë një periudhe të pazakontë.

Z. Mete theksoi se në veçanti gjatë viteve të fundit ekonomia dhe tregjet financiare janë përballur me sfida të shumta dhe në raste të tilla përcjellja me objektivitet e realitetit dhe zhvillimeve tek qytetarët merr një rëndësi edhe më të posaçme.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv u shpreh se Autoriteti do të vijojë të ketë një komunikim të hapur e transparent me mediat dhe përmes tyre edhe me publikun, në funksion të përcjelljes së mesazheve të duhura.

Z. Mete nënvizoi se tregjet financiare nën mbikëqyrjen e Autoritetit paraqiten të qëndrueshëm sa i përket treguesve kryesorë të shëndetit financiar, edhe pas një viti sfidues, të shoqëruar me pasiguri e luhajtje. Ai vuri në dukje zhvillimet kryesore të viteve të fundit, në aspektin legjislativ e rregullator, që kanë modernizuar tregjet nën mbikëqyrje dhe kanë avancuar më tej përafrimin me kuadrin evropian.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv u shpreh se fokusi i Autoritetit për vitin në vazhdim do të jetë monitorimi i kujdesshëm i tregjeve në funksion të garantimit të stabilitetit financiar, avancimi drejt standardeve ndërkombëtare të IAIS në sigurime, modernizimi i sistemeve të raportimit dhe analizave financiare, si edhe avancimi drejt mbikëqyrjes së plotë me bazë risku për të gjitha tregjet.

VËSHTRIM MBI TREGJET

Ecuria e tregut të sigurimeve në Shqipëri, Janar–Nëntor 2022


Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për periudhën janar-nëntor 2022 kapën vlerën 18,394 milionë lekë, ose 9.01% më shumë se në janar-nëntor 2021. Gjatë periudhës janar-nëntor 2022, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 1,193,221 me një rritje prej 13.02% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tregu mbetet i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 91.88% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, ndërsa sigurimet e Jetës kanë 7.86%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 38.23% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 61.77% të totalit të tregut.

Gjatë periudhës janar-nëntor 2022, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 6,140 milionë lekë, ose 2.31% më shumë se në periudhën janar-nëntor 2021.

Dëmet e paguara bruto në sigurimin motorik për periudhën janar-nëntor 2022 kapën vlerën 3,990 milionë lekë, duke pësuar një rritje me rreth 9.96% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Struktura e tregut të sigurimeve, Janar– Nëntor 2022 (Në %)



Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik, gjatë periudhës janar-nëntor 2022 arritën rreth 11,696 milionë lekë, ose 9.50% më shumë se në periudhën janar-nëntor 2021.

ZHVILLIME TË TJERA

Përafrimi legjislativ me BE-në dhe praktikat mbikëqyrëse, AMF dhe MFSA nënshkruajnë Memorandum Mirëkuptimi



Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) dhe Autoriteti i Shërbimeve Financiare të Maltës (MFSA) nënshkruan një Memorandum Mirëkuptimi në kuadër të shkëmbimit të informacionit dhe bashkëpunimit mes dy rregullatorëve. Marrëveshja u nënshkrua nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, z. Ervin Mete dhe Drejtoresha Ekzekutive e MFSA-së, znj. Michelle Mizzi Buontempo.

Marrëveshja përcakton një kuadër të qartë bashkëpunimi mes dy rregullatorëve në të gjitha fushat ku ata ushtrojnë funksionet e tyre mbikëqyrëse, tregun e kapitaleve, tregun e sigurimeve, fondet e investimeve, fondet e pensioneve private, si edhe atë të tregjeve financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë.

Në fjalën e mbajtur me këtë rast, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv u ndal te rëndësia e bashkëpunimit mes Autoritetit dhe rregullatorëve të vendeve të Bashkimit Evropian. “Me hapjen e negociatave me BE-në, Shqipëria është angazhuar në negociimin e kapitujve, ku Autoriteti udhëheq kapitullin 9-të “Shërbimet Financiare”. Në këtë drejtim, është me rëndësi të veçantë vendosja e urave të bashkëpunimit me rregullatorët evropianë, për të përfituar nga eksperiencia dhe asistenca e tyre si në funksion të përafrimit me legjislacionin e BE-së, ashtu edhe sa i përket avancimit drejt praktikave më të mira të mbikëqyrjes. Si një nga vendet e para të BE-së që ndërmoi rregullimin e shërbimeve financiare të ofruara përmes teknologjisë së regjistrave të shpërndarë, Malta ka një ekspertizë të thelluar në këtë fushë, e cila mund t'i shërbejë më së miri edhe Shqipërisë.”

Përafrimi legjislativ me BE-në dhe praktikat mbikëqyrëse, AMF dhe MFSA nënshkruajnë Memorandum Mirëkuptimi

... vijon

Drejtoresha Ekzekutive e MFSA-së, znj. Buontempo shprehu gadishmërinë për të mbështetur Autoritetin, si edhe vlerësoi se bashkëpunimi mes rregullatorëve është kyç përkundrejt zhvillimeve të vrullshme teknologjike dhe ndërlidhjes së tregjeve financiare. “MFSA do t’u japë të gjithë asistencën e nevojshme kolegëve shqiptarë, në funksion të harmonizimit të rregulloreve me kuadrin ligjor evropian. Gjithashtu, shkëmbimi i informacionit dhe praktikave më të mira do të na shërbejë në arritjen e qëllimit të përbashkët për një mbikëqyrje sa më efektive të tregjeve financiare.”

Gjatë qëndrimit në Maltë, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv u takua gjithashtu me Guvernatorin e Bankës Qendrore të Maltës, z. Edward Scicluna. Në takim u nënvizua nevoja e bashkëpunimit të ngushtë mes institucioneve financiare, me qëllim maksimizimin e objektivave të përbashkëta, në funksion të garantimit të stabilitetit financiar, krijimit të një ambjenti sa më të përshtatshëm për operatorët e tregjeve, si edhe mbrojtjes së konsumatorëve e investitorëve.

AMF, tryeza diskutimi me përfaqësues të tregut mbi kuadrin rregullator të tregjeve të kapitalit



Nga data 5-16 dhjetor 2022, Autoriteti Mbikëqyrjes Financiare në bashkëpunim me Bankën Botërore dhe Sekretariatit Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO) zhvilloi një seri tryezash diskutimi mbi kuadrin rregullator për tregjet e kapitalit.

Në këto takime u diskutua me përfaqësues të subjekteve që operojnë në tregjet e kapitalit si dhe institucioneve me rol kyç në këto tregje në lidhje me projektregulloret e reja, të hartuara në përputhje me Direktivat e Bashkimit Evropian dhe në zbatim të Ligjit nr. 62/2020 "Për Tregjet e Kapitalit".

Ekspertët e huaj, të cilët kanë asistuar Autoritetin në hartimin e kuadrit të ri ligjor e rregullator për tregjet e kapitalit shkëmbyen mendime me përfaqësues të tregut të kapitalit dhe palët e interesit në lidhje me funksionimin në praktikë të projektregulloreve. Gjatë takimeve të pranishmit dhanë mendimet e tyre, si edhe shtruan pyetje për çështje të caktuara.

Disa prej projektregulloreve të trajtuara në këto takime ishin:

- Projektregullorja “Për formën dhe përmbajtjen e prospektit që publikohet kur titujt i ofrohen publikut dhe pranohen për tregtim në një treg të rregulluar”;
- Projektregullorja “Për kërkesat e transparencës në lidhje me informacionin e shoqërive të listuara”;
- Projektregullorja “Për mjaftueshmërinë e kapitalit të shoqërisë komisionere”;

vijon ...

AMF, tryeza diskutimi me përfaqësues të tregut mbi kuadrin rregullator të tregjeve të kapitalit

...vijon

- Projektregullorja “Për ushtrimin e veprimtarisë operacionale të shoqërive komisionere dhe bankave që ofrojnë shërbime investimi”;
- Projektregullore “Për kriteret e licencimit dhe funksionimit të operatorëve të tregut dhe bursave që vënë në funksion veprimtarinë e një tregu të rregulluar dhe operatorëve të njohur të tregut”;
- Projektregullore “Mbi emërimin dhe kriteret e audituesve ligjorë të shoqërive komisionere”;
- Projektregullore “Për kriteret e licencimit dhe funksionimit të Depozitarit Qendror të Titujve”, etj.

Aktet e reja rregullatore avancojnë më tej standardet për mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë së subjekteve të tregut të kapitaleve dhe mbikëqyrjen e tyre, në funksion të zhvillimit të mëtejshëm të këtij tregu dhe mbrojtjes së investitorit. Me përfundimin e procesit të hartimit të projektregulloreve në zbatim të ligjit të ri për tregjet e kapitalit, plotësohet e gjithë baza rregullatore për këto tregje, duke e përafëruar me legjislacionin e BE-së, edhe në kuadër të procesit të negociatave për kapitullin 9 “Shërbimet Financiare”, i cili udhëhiqet nga AMF.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, takim me Shoqatën e Siguruesve të Shqipërisë



Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, z. Ervin Mete ishte i pranishëm në pritjen e fundvitit të Shoqatës së Siguruesve të Shqipërisë (SHSSH). Në fjalën e mbajtur, z. Mete u ndal në zhvillimet kryesore të tregut të sigurimeve gjatë vitit 2022, si edhe parashtrori disa nga prioritetet e Autoritetit për vitin 2023.

Z. Mete u shpreh se tregu i sigurimeve është shfaqur rezistent përballë ndikimeve të ngjarjeve të njëpasnjëshme, siç ishin tërmeti i vitit 2019, pandemia dhe së fundmi luhatjet e tregjeve financiare ndërkombëtare, të shoqëruara me rritjen e inflacionit dhe pasigurisë ekonomike. Viti 2022 solli një përmirësim të mëtejshëm të treguesve kryesorë financiarë, reduktim të numrit të dëmeve pezull, daljen e Byrosë Shqiptare të Sigurimit nga monitorimi thuajse 10-vjeçar i Këshillit të Byrove, uljen e ndjeshme të komisioneve të ndërmjetësimit, zgjidhjen e një mase të konsiderueshme të praktikave të dëmeve përmes Raportit Evropian të Aksidenteve, si edhe përmirësimin e mëtejshëm të situatës me Fondin e Kompensimit.

“Në tërësi, viti 2022, edhe pse një vit sfidues, për shkak të efekteve të faktorëve të jashtëm, të shoqëruar me rritje të inflacionit dhe pasigurive, tregu i sigurimeve u paraqit i qëndrueshëm në terma të treguesve kryesorë të shëndetit financiar. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit dhe totali i aktiveve të tregut të sigurimeve kanë shënuar rritje, ndërsa raporti dëme-prime ka vijuar të përmirësohet,” u shpreh Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së.

Numri i dëmeve pezull në 9-mujorin e vitit 2022 është ulur me rreth 24.5% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Komisionet e ndërmjetësimit janë ulur në një mesatare tregu prej 17.5%, nga mbi 27% që ishin përpara hyrjes në fuqi të rregullores së AMF-së në janar 2022. Gjithashtu, nga hyrja në fuqi e ligjit të ri më 1 korrik 2021, 87% e aksidenteve të shkaktuara nga mjetet e pasiguruara ose të paidentifikuara janë trajtuar përmes mekanizmit të siguruesit të drejtpërdrejtë, si një nga risitë e ligjit. Raporti Evropian i Aksidenteve është përdorur në rreth 20% të rasteve për dëmet e raportuara në 9 muajt e parë të vitit 2022.

PUBLIKIME PROFESIONALE

IAIS publikon “Raportin e Tregut Global të Sigurimeve, GIMAR 2022”



<https://www.iaisweb.org/2022/12/iais-global-insurance-market-report-2022-highlights-key-risks-and-trends-facing-the-global-insurance-sector/>

IAIS ka publikuar “Raportin e Tregut Global të Sigurimeve, GIMAR 2022”, duke paraqitur rezultatet e “Ushtrimit Global të Monitorimit” (GME), kuadrin e IAIS për monitorimin e rreziqeve dhe tendencave në sektorin global të sigurimeve dhe vlerësimin e rritjes së mundshme të rrezikut sistemik. Raporti i Tregut Global të Sigurimeve IAIS GIMAR 2022 thekson rreziqet dhe tendencat kryesore me të cilat përballet sektori global i sigurimeve. Ky raport bazohet në të dhënat e mbledhura nga 60 grupet më të mëdha ndërkombëtare të sigurimeve dhe të dhëna të përmbledhura në të gjithë sektorin nga mbikëqyrësit në të gjithë globin, duke mbuluar mbi 90% të primeve të shkruara në shkallë globale.

“Përmes GME-së, IAIS monitoron tendencat dhe zhvillimet e tregut global të sigurimeve, zbulon rritjen e mundshme të rrezikut sistemik dhe ndihmon në një diskutim kolektiv mbi përgjigjen e duhur mbikëqyrëse në nivel sektorial dhe individual të siguruesit,” tha Vicky Saporta, drejtues i Komitetit Ekzekutiv të IAIS. “Analiza jonë arrin në përfundimin se rreziku sistemik në sektorin e sigurimeve është i moderuar në agregat dhe i ulët në raport me atë të sektorit bankar, megjithatë rezultatet totale të rrezikut sistemik të siguruesve kanë prirje në rritje.”

Tendenca drejt rezultateve më të larta totale të rrezikut sistemik është nxitur nga ekspozimet në rritje ndaj aktiveve jolikuide, të vështira për t'u vlerësuar (aktive të nivelit 3), derivativëve pa bursë, financimit afatshkurtër (në veçanti transaksioneve të riblerjes) dhe aktiveve ndërfinanciare. (përfshirë risigurimin). Kjo kontribuon në dobësitë e mundshme për sektorin e sigurimeve, veçanërisht në kushtet e rritjes së shpejtë të normave të interesit.

Vijon ...

IAIS publikon Raportin e Tregut Global të Sigurimeve, GIMAR 2022

...vjon

GME 2022 zbuloi se pozicionet e aftësisë paguese dhe të përfitimit të siguruesve u përmirësuan në total në sektorin global të sigurimeve gjatë vitit 2021, mbështetur nga performanca e fortë në tregjet financiare. Cilësia e përgjithshme e kredisë për aktivet e siguruesve është e lartë; megjithatë, ekspozimi ndaj aktiveve nën shkallën e investimit është rritur. Për sa i përket masave të aftësisë paguese, disa sigurues vazhduan të blinin aksione dhe/ose të riblenin borxhin e varur. Të tjerë emetuan kapital dhe/ose borxh të varur për të forcuar pozicionet e kapitalit dhe likuiditetit. Masat e marra nga siguruesit për ruajtjen ose përmirësimin e përfitueshmërisë përfshinin optimizimin e shpërndarjes së kapitalit dhe menaxhimit të asset-detyrimeve, realizimin e fitimeve nga investimet, transformimin dixhital, diversifikimin e ofertave të produkteve dhe burimeve të të ardhurave dhe optimizimin e politikave të marrjes në sigurim dhe përcaktimit të çmimit. Që nga viti 2022, disa faktorë makroprudencialë kanë krijuar pasiguri, duke përfshirë konfliktet gjeopolitike, inflacionin, shtërngimin e politikës monetare dhe përkeqësimin e perspektivës ekonomike që çon në rritjen e rreziqeve të tregut, kredisë dhe likuiditetit.

GME 2022 mbulon tre tema makroprudenciale për të gjithë sektorin, të cilat u identifikuan si fusha prioritare mbikëqyrëse:

1. Perspektiva makroekonomike më e ulët, inflacioni i lartë dhe rritja e normave të interesit. Për siguruesit e Jetës, rritja e normave të interesit mund të ketë efekte pozitive në pozicionet e aftësisë paguese, por rritjet e shpejta të normave të interesit gjithashtu mund t'i ekspozojnë siguruesit ndaj rreziqeve të likuiditetit. Për siguruesit e Jo-Jetës, inflacioni më i lartë rrit shpenzimet dhe madhësinë e dëmeve, përveç rivlerësimit të rezervave. Në nivel global, mbikëqyrësit kanë rritur monitorimin dhe mbikëqyrjen e rreziqeve për sektorin e sigurimeve që rrjedhin nga mjedisi aktual, duke përfshirë rrezikun e kredisë dhe rrezikun e likuiditetit.
2. Ndryshimet strukturore në sektorin e sigurimit të Jetës, edhe me përfshirjen e firmave të kapitalit privat. Firmat private të kapitalit angazhohen në sektorin e sigurimeve përmes investimeve, blerjeve, partneriteteve, risigurimeve dhe marrëveshjeve të tjera. Në disa juridiksione, kjo përfshirje e firmave të kapitalit privat është shoqëruar me ekspozim më të lartë ndaj aktiviteteve të tilla si risigurimi ndërkuftar dhe shpërndarja e aktiveve ndaj aktiveve komplekse dhe jolikuide, duke vënë në dukje se këto aktivitete nuk janë të reja ose ekskluzive për siguruesit e përfshirë në kapitalin privat.

IAIS publikon Raportin e Tregut Global të Sigurimeve, GIMAR 2022

...vijon

3. Rreziqet e lidhura me klimën. Mungesa e progresit në reduktimin e emetimeve globale të karburanteve fosile po kontribuon në rritjen e tranzicionit dhe rreziqeve fizike nga ndryshimet klimatike në sektorin e sigurimeve. IAIS mbështet mbikëqyrësit për të forcuar të kuptuarit e tyre për llojin dhe madhësinë e ekspozimeve të lidhura me klimën në sektorin e sigurimeve në mënyrë që të informojnë përgjigjet efektive mbikëqyrëse. Boshllëqet në mbrojtjen kundër rreziqeve të lidhura me klimën në shumë raste janë të rëndësishme dhe mbikëqyrësit parashikojnë se ato do të vazhdojnë të rriten, prandaj roli që mbikëqyrësit mund të luajnë për të ndihmuar në adresimin e boshllëqeve të mbrojtjes që lidhen me klimën do të jetë në fokus për IAIS në vitet në vijim.

IAIS do të vazhdojë të monitorojë në mënyrë aktive këto rreziqe të tregut global të sigurimeve dhe të përsosë vlerësimin e tij të rrezikut sistemik, duke përfshirë rishikimin e rregullt tremujor të GME që do të finalizohet në vitin 2023. Në fillim të vitit të ardhshëm, IAIS do të publikojë gjithashtu një GIMAR të veçantë, raport tematik, për rrezikun kibernetik.



IAIS

INTERNATIONAL ASSOCIATION OF
INSURANCE SUPERVISORS



GREQI

www.xprimm.com

Sipas shifrave paraprahe të tregut të sigurimeve të publikuara nga HAIC, Shoqata Helenike e Shoqërive të Sigurimeve, në fund të tremujorit të tretë 2022, tregu grek i sigurimeve arriti në 3.19 miliardë euro, duke u rritur vetëm me 0.3% në terma vjetorë.

Segmenti i sigurimeve të Jo-Jetës u rrit me 5.3% në terma vjetorë duke arritur në 1.66 miliardë euro, nga të cilat 547.4 milionë euro sigurimi MTPL dhe 355.1 euro – sigurimi i pasurisë. Biznesi i sigurimit të Jetës ra me -5.2%, në terma vjetorë, duke arritur në 1.42 miliardë euro, për shkak të dinamikës negative të raportuar nga produktet tradicionale të sigurimit të Jetës, të cilat zbritën me -10.4%.

Shifrat e tregut të publikuara nga HAIC përfshijnë të dhënat për 52 kompani sigurimesh, nga të cilat 17 ishin aktive në sigurimet e Jetës (dhe përbënin 99.9% të të dhënave të plota të segmentit të tregut) dhe 45 ishin aktive në sigurimet e Jo-Jetës (94.5% pjesë e tregut).

HUNGARI

www.xprimm.com

Sipas statistikave tremujore të publikuara nga Banka Qendrore e Hungarisë, në fund të shtatorit 2022, siguruesit në vend realizuan një vëllim të primeve të shkruara bruto me vlerë 1,104 miliardë HUF ose rreth 2.6 miliardë euro. Kjo shifër shënon një rritje me 11.2% në terma vjetore. Gjatë nëntëmujorit, tregu i sigurimit të Jetës zinte 43% me një vëllim prej 475 miliardë HUF. Ndërsa tregu i sigurimeve të Jo-Jetës përbën 57% të primeve të shkruara bruto me një total 628 miliardë HUF.

Në fund të shtatorit 2022, në tregun hungarez të sigurimeve ishin aktive 22 sigurues: 4 sigurues të specializuar të Jetës, 9 sigurues të Jo-Jetës dhe 9 sigurues të përbërë.

POLONI

www.xprimm.com

Tregu më i madh i sigurimeve në Evropën Qendrore dhe Lindore, Polonia, shënoi një rritje të vëllimit të primeve të shkruara bruto, për 3-tremujorin e vitit 2022, me vlerë 57.7 miliardë PLN, ose rreth 10.8 miliardë euro. Sipas statistikave tremujore të publikuara nga KNF polake, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Polonisë, vërehet një rritje me 3.6% në terma vjetore. Në të njëjtën kohë, dëmet e paguara bruto nga siguruesit vendas u rritën me rreth 11% në terma vjetore duke arritur në 33.6 miliardë PLN ose 6.9 miliardë euro.

Vëllimi i primeve të shkruara bruto në sigurimin e Jetës u ul me 4.2% në terma vjetore duke arritur në 15.9 miliardë PLN ose 3.3 miliardë euro. Ndërsa tregu i sigurimit të Jo-Jetës u rrit me 7.3% duke arritur në 36.9 miliardë PLN ose 7.6 miliardë euro.

QIPRO

www.xprimm.com

Sipas të dhënave tremujore të publikuara nga Shoqata e Sigurimeve të Qipros, IAC, tregu i sigurimeve të Qipros arriti në 765.5 milionë euro në fund të shtatorit 2022, duke u rritur me mbi 9% në terma vjetorë.

Sigurimet e Jetës u rritën me 15.8% në terma vjetorë duke arritur në 374.4 milionë euro, ndërsa segmenti i sigurimit të Jo-Jetës raportoi një rritje prej 3.5%, duke arritur në 391.1 milionë euro. Tre klasat kryesore të Jo-Jetës: “Aksidentet dhe shëndeti”, “Zjarri” dhe “Sigurimet motorike” arritën në 334.1 milionë euro, pothuajse 44% e totalit të tregut, ose 85% e vëllimit të primeve të shkruara bruto të Jo-Jetës.

Vlera e dëmeve të paguara në tregun e sigurimit të Jetës arriti në 163.6 milionë euro, me rritje 7.4% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021. Ndërsa dëmet e paguara bruto për sigurimin e Jo-Jetës u rritën me 4.7% në terma vjetorë, duke arritur në 169.4 milionë euro.

Vlen të përmendet se të dhënat e publikuara nga Shoqata e Sigurimeve të Qipros pasqyrojnë biznesin lokal të sigurimeve nga kompanitë anëtare të saj, të cilat përfaqësojnë përafërsisht 98% e të gjithë vëllimit të primeve të shkruara bruto.

ROMANI

www.xprimm.com

Bazuar në statistikat e Autoritetit Rumun të Mbikëqyrjes Financiare, në fund të 9-mujorit 2022, kompanitë e sigurimit të licencuara në Rumani realizuan prime të shkruara bruto me vlerë 2.43 miliardë euro, duke shënuar një rritje 23% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Duke i shtuar kësaj shume, edhe primet e shkruara që u gjeneruan nga siguruesit që operojnë në sistemin FOE (kompani të lira për tu vendosur pavarësisht vendit të origjinës), vëllimi total i tregut arriti në 2.7 miliardë euro. Sigurimet e Jo-Jetës përbënin 83% të vëllimit total të tregut.

Dëmet e paguara bruto nga të gjithë siguruesit që operojnë në tregun rumun, si dhe nga Fondi i Garancisë së të Siguarave (FGA) arritën në 1.27 miliardë euro. Dëmet e paguara për sigurimet e Jo-Jetës arritën në rreth 80% të totalit. Shumat e miratuara për pagesën e dëmeve nga FGA arritën në rreth 99.8 milionë euro, nga të cilat afërsisht 94% përfaqësojnë shumën e miratuara për pagesën e dëmeve të MTPL.

Linjat e sigurimeve motorike mbetën dominuese. Primet e shkruara bruto për Sigurimin Kasko dhe MTPL përbëjnë së bashku rreth 77% të primeve të shkruara bruto të Jo-Jetës, ose 64% të primeve të shkruara bruto totale. Në të njëjtën kohë, dëmet e paguara për të dy segmentet e tregut përbëjnë 86% të dëmeve për sigurimet e Jo-Jetës dhe pothuajse 68% të vëllimit total të dëmeve të paguara.

SLLOVAKI

www.xprimm.com

Sipas shifrave të publikuara nga SLASPO (Shoqata Sllovake e Sigurimeve), në fund të tremujorit të tretë, janar – shtator 2022, vëllimi i primeve të shkruara bruto për anëtarët e shoqatës arriti në 1.95 miliardë euro, me një rritje prej 4.42% në vit.

Primet e shkruara në sigurimet e Jetës u ulën me 0.5% në terma vjetore, duke arritur në 772 milionë euro. Ndërsa tregu i sigurimeve të Jo-Jetës u rrit me 7.9% në terma vjetore duke arritur në 1.18 miliardë euro.

SLLOVENI

www.xprimm.com

Sipas raportimit nga Shoqata Sllovene e Sigurimeve, të dhënat e tregut në fundit të shtatorit 2022, pasqyrojnë një rritje me 4.8% të primeve të shkruara bruto për siguruesit vendas, duke arritur në 2.14 miliardë euro.

Primet e sigurimit të Jo-Jetës u rritën me 6.7% në terma vjetore, duke arritur në 1.56 miliardë euro, ndërsa primet e Jetës ranë me 0.13%, në 575 milionë euro gjatë periudhës nëntëmujore.

Shifrat e publikuara nga shoqata lokale e sigurimeve përfshijnë të dhënat nga 17 sigurues.

TURQI

www.xprimm.com

Sipas shifrave tremujore të publikuara nga Shoqata e Kompanive të Sigurimeve dhe Risigurimeve të Turqisë, TSB, në fund të shtatorit 2022 tregu vendas i sigurimeve u rrit me 108% në terma vjetore, duke arritur në 146.9 miliardë TRY ose rreth 8.1 miliardë euro. Ky vëllim i tregut, i shprehur në monedhën evropiane, për shkak të diferencave të kursit të këmbimit, shënonte rritje me +18%.

Vëllimi i primeve të shkruara bruto në sektorin e Jetës u rrit me 67% në terma vjetore, duke arritur në 20.5 miliardë TRY. Ndërsa në sigurimin e Jo-Jetës, vëllim i primeve u dyfishua me një rritje +116.8% në terma vjetore, duke arritur 126.3 miliardë TRY. Rritjet më të mëdha u realizuan nga nënklasat e sigurimeve motorike: Sigurimi Kasko +187% dhe MTPL +119% terma vjetore.



AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Për informacion të mëtejshëm
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al